Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0561

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si Kryetare, Isa Hasani-Referues dhe Vedat Poterqoi si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "RSM Company" Sh.P.K. të datës 07.08.2023 si dhe mbi ankesën e operatorit ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)" të datës 10.08.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 21.07.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjilanit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit" me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 18.12.2023 merr këtë:

Vendim

1.Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "RSM Company" Sh.P.K. me nr. 2023/0549 e datës 07.08.2023 ashtu që **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin të datës 21.07.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjilanit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit" me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim.**

2.Refuzohet si e pabazuarankesa e operatorit ekonomik "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)" me nr. 2023/0561 e datës 10.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së asnkesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës kurse konfiskohen sa i përket OE "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)" konform nenin 31 pargarfi 5 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 03.09.2022 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit" me numër të prokurimit 651-22-10313-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 340,000.00€.

Me datë 21.07.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë grupin e operatorëve ekonomik "AVAG Group Sh.P.K & Sinjal Sh.P.K".

Me datë 24.07.2023 operatori ekonomik ankues "RSM Company" Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 27.07.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 07.08.2023 operatori ekonomik ankues "RSM Company" Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0549.

Me datë 10.08.2023 operatori ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 26.07.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 31.07.2023 operatori ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)" ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0561.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2023/0549 dhe ankesa nr. 2023/0561 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "RSM Company" Sh.P.K. janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: "Në dosje të tenderit pika 9.1 & 9.2 te kërkesa 1 është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike, ndërtim të semaforëve) gjatë 3 viteve të fundit. Në një vlerë prej jo më pak së 450.000,00€. Ne kemi paraqitur listën e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit ku kemi paraqitur dëshmitë e mjaftueshme për të plotësuar këtë kriter. Insistimi i AK lidhur me raportin përfundimtar të datës 23.06.2021 se nuk ka vulë dhe nuk ka nënshkrim dhe për shkak se Ministria e Infrastrukturës nuk ka kontratë për ekzaminime laboratorike, AK në këtë rast vie në konkludim dhe paragjykim në kundërshtim të plotë me Ligjin e Prokurimit, duke mos kërkuar asnjë lloj sqarimi as nga ana jonë as nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës ku në sqarimin tonë të fundit të dt. 11.07.2023, i kemi shkruar kontaktet e menaxherit të kontratës dhe zyrtarit tjetër të MI që nëse kanë diqka të paqartë mund të kontaktojnë edhe te ata lidhur me kontratën në fjalë. Kontrata në fjalë e paraqitur nga ana jonë është kontratë kornizë me afat 36 muaj. Kjo kontratë dhe asnjë nga kontratat për lotet tjera që kanë patur kompanitë tjera nuk kanë pranim teknik përfundimtar. Për këtë mund të vërtetoni te Ministria e Infrastrukturës. Me rastin e dorëzimit të situacionit përfundimtar të punimeve, paraprakisht dorëzohet edhe Garancioni i Kualitetit të Punimeve me afat 24 muaj. Pastaj përpilohet Raporti Përfundimtar nga Menaxheri i Projektit. Meqenëse AK i pengon që ky raport është dorëzuar pa nënshkrim të menaxherit të kontratës, po ju bashkangjitim raportin e nënshkruar. Ndërsa sa i përket datës së referencës, nuk e kemi të qartë se AK i intereson se kur janë kryer punimet apo kur lëshohet referenca, pasi që një referencë mund të lëshohet edhe pas 5 apo 10 viteve por nuk është valide. Prandaj sipas referencës mund të vërtetohet që punimet janë kryer sipas datave që kemi cekur në listën e dorëzuar".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "RSM Company" Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7 dhe 59 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 08.08.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 21.08.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "ankesa të miratohet si pjesërisht e bazuar ndërsa njoftimi mbi vendimin i datës 21.07.2023 të mbetet në fuqi".

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)" janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: "AK ka kërkuar informata për disa çmime që ju kanë dukur jo normalisht të ulëta dhe ne i kemi derguar sqarime sikurse parashihet me paragrafin 2 - 2.1 - 2.3 - 2.4 të nenit 61 të LPP dhe paragrafit 3 të nenit 61 të LPP. Edhe pse ne kemi dhënë përgjigje-sqarime në harmoni me paragrafët e nenit 61, AK në kundërshtim me pargrafin 2 të nenit 61 nuk i ka marrë parasysh shpjegimet tona të dorëzuara dhe padrejtësisht na ka eleminuar edhe pse ne

për secilin pozicion kemi dhënë arsyetim ligjor se nuk kemi ofertuar me asnjë çmim jo normalisht të ulët por të njëjtit janë në harmoni me çmimet e tregut, dhe kemi dalë me çmim të poentuar më të lirë. Shkelja flagrante e AK duke konstatuar se nuk u bindë me përgjigjet e pranuara nga OE ankues. Komisioni nuk ka nevojë të bindet por i njejti duhet të veproj në rastin konkret komisioni për rivlerësim nuk ka ushtruar asnjë nga kompetencat që ja jep ligji konkretisht neni 59 dhe 61 i LPP-së sepse: (vijon) nuk ka marrë parasysh sqarimet, shpjegimet e OE të cilat i ka ofruar për secilin pozicion madje edhe i ka ofruar mundësin e rritjes së sigurisë së ekzekutimit në çfarëdo përqindje. Nuk ka bërë asnjë hulumtim të tregut, perveç që nuk ka dalë në terren i njëjti nuk ka bërë asnjë mund që të bëj hulumtim e tregut as përmes internetit".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "RSM Company" Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 10, 59, 60, 61 dhe 108/A të LPP si dhe nenin 40 të RRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11.08.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 25.08.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "ankesa të miratohet si pjesërisht e bazuar ndërsa njoftimi mbi vendimin i datës 21.07.2023 të mbetet në fuqi".

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorëve ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "RSM Company" Sh.P.K., eksperti shqyrtues në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet si në vijim: "operatori ekonomik ankues në listën e kontratave të realizuara me nr. rendor 1, 2 dhe 3 e ka specifikuar kontratën me titull - sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale të Kosovës Lot 5 - dhe me nr. të prokurimit MI 17 0061 511, e njëjta kontratë është përshkruar tri herë e ndarë nëpër vite, për vitin 2018-2019, vitin 2019-2020 si dhe për vitin 2020-2021, sipas dokumeteve kjo kontrate është nënshkruar në mes të OE ankues dhe Ministrisë se Infrastrukturës në vitin 2018 për periudhën prej 36 muajsh. Për këtë kontratë së bashku me listën janë prezentuar edhe referenca të lëshuara nga MI për vitin 2018-2019 dhe 2019-2020 të cilat referenca janë të specifikuar si - referenca për vitin 2018-2019 sipas situacionit lirimit të ruajtjes së datës 21.06.2019 e lëshuar me 21.07.2020 dhe e protokolluar me datë 28.07.2020 si dhe referenca për vitin 2019-2020 sipas situacionit lirimit të ruajtjes të datës 05.05.2020 e lëshuar me datë 21.07.2020 dhe e protokolluar me datë 28.07.2020. Ndërsa për vitin 2020-2021 ka prezentuar dokumentin me titull raport përfundimtar i punëve të kryera në kontratën -sinjalizimi dhe

mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale dhe rajonale Republikës së Kosovës për lot V- sipas kontratës me nr. 44/2018 me numër të prokurimit MI/17/061/511 për vitet 2020-2021. Ky dokumet është përgatitur nga menaxheri i projektit me datë 23.06.2021 dhe i njëjti nuk është i nënshkruar nga asnjëra palë. Me datën 10.07.2023 përmes letrën standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit AK ka kërkuar sqarime shtesë te OE ankues. Tutje OE ankues ka kthyer sqarimet si dhe ka bashkangjitur referencat e specifikuara dhe të njëjtat janë të nënshkruara si dhe raportin përfundimtar të menaxherit të projektit të datës 23.06.2021. Në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesë OE ka prezentuar Raportin Përfundimtar të menaxherit të projektit të datës 23.06.2021 të nënshkruar nga të dyja palët. Nga dokumetet e prezentuara nga ana e OE ankues shihet se i njëjti për kontratën - sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale të Kosovës Lot 5 - me nr. të prokurimit MI 17 0061 511 ka dorëzuar dokumente/dëshmi të pjesshme (për secilin vit nga një referencë apo raport). Në lidhje me këtë eksperti shqyrtues mendon se përputhje me LPP, legjislacionin sekondar dhe interpretimin e KRPP, OE ankues është dashur që për kontratën e njëjtë të dorëzoj një dokument përfundimtar (referencë apo raport) për realizimin e kontratës në fjalë ashtu siç e specifikon LPP, legjislacioni sekondar dhe interpretimi i KRPP, dokumeti i tillë do t'i eliminonte të gjitha paqartësitë e krijuara në lidhje me dokumetet të cilat i ka dorëzuar Operatori Ekonomik. Ashtu siç e ka specifikuar AK në Raportin e Ri-vlerësimit të datës 21.07.2023 dhe në Vendimin e Kërkesës për Rishqyrtim të datës 27.07.2023 operatori ekonomik ankues ka dorëzuar dokumente shtesë të cilat përmbajnë datën pas datës së dorëzimit të ofertave. Këto dokumete janë në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP pastaj nenin 39 dhe 41 të RRPP. Pasi që aktiviteti i prokurimit është publikuar me 30 shtator të vitit 2022, janë marrë për referim nenet e specifikuara të RRPP si dhe interpretimi i KRPP i datës 26.06.2020. Në bazë të sqarimeve të specifikuara më lartë për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar. Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike në e-prokurim, rrjedhën dhe procedurën e prokurimit me këtë aktivitet të prokurimit është në përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoriteti Kontraktues që vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave të bëhen në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP si dhe legjislacionit sekondar të prokurimit".

OE ankues ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit ngase sipas tij/saj kan pohuar si në vijim:kemi paraqitur deshmi te mjaftueshme qe plotesojme kriterin e kontratave te ngjashme ne vlere prej se paku 450,000 Euro ne lemine e kerkuar. Data e leshimit te References nuk luan asnje rol pasi qe edhe ne Reference eshte e cekur mjafte qarte qe te gjitha punimet jane perfunduar me dt. 23.06.2021, ku me kete date eshte kryer edhe pranimi i puneve te realizuara. OSHP mund te kerkoje sqarim edhe tek AK ne menyre qe te qartesohen te gjitha keto, dhe te vertetohen pohimet tona.

Nga ana tjetër, AK ka deklaruar se pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues qe kjo ankese te refuzohet dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)", eksperti shqyrtues në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet si në vijim: "Eksperti shqyrtues, vlerëson se koncepti i tendereve jo normalisht i ulët i referohet tenderëve që për AK në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohen me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat. Sipas nenit 61 të LPP dhe nenit 4 të B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, eksperti shqyrtues mendon se janë plotësuar kushtet për cilësimin e ofertës jo

normalisht të ulët. Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 4.2 të B57 Rregullat për Tenderët Jo Normalisht të Ulët, me dt. 26.06.2023 ka kërkuar sqarime nga OE ankues për disa çmimet në pozicionet me nr. 1.6, 1.12, 1.13, 2.1, 2.2, 2.3, 3.2, pozicioni nen 3.2 (pa numër), 3.5, 3.7, 4.7, 4.9, 5.1, 5.3, 5.4 dhe 5.5. Me dt. 29.06.2023 OE ankues i përgjigjet AK me arsyeshmërinë e çmimeve sipas mënyrës së tij. Ashtu si kërkohet në nenin 4 të B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët në rastin konkret AK ka ndjekur procedurën Inter Partes me OE ankues. Në përgjigjen e O.E ankues ka ofruar çmime të furnizimit për disa pozicionet nërsa nuk ka ofruar detaje tjera shtesë sikurse kërkohen në bazë të legjislacionit në fuqi. Në sqarimet e tij OE ka ofruar çmimet e furnizimit për pozicionin 1.6, 1.12 1.13, 2.1, 2.2, 2.3, 3.7 ndërsa për pozicionin 4.7 ka prezantuar dëshmi që çmimi i furnizimit të tyre është për disa herë me i lartë se sa çmimi me të cilin ka ofertuar, në bazë të një hulumtimi ne internet shihet se modeli i prezentuar per pozicionin 4.7 nga ana e OE ankues ka një kosto shumë më të lartë se sa që ka ofertuar OE ankues. Ndërsa për pozicionet 3.2, pozicioni nen 3.2 (pa numër), 3.5, 4.9, 5.1, 5.3, 5.4 dhe 5.5 në përgjigjen e tij ka dhënë sqarime sipas mënyrës së tij por nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që të dëshmoj arsyeshmërinë e këtyre çmimeve. Pasi që OE ankues në përgjigjen e tij arsyetimin e çmimeve të ofruara te disa pozicione e ka lidhur me mirëmbajtje është kërkuar sqarim nga Autoriteti Kontraktues se për ata artikuj a është kërkuar të bëhet furnizim apo mirëmbajtje nga përgjigja e pranuar nga ana e AK si dhe përshkrimi për këta akrtikuj në paramsë dhe parallogari që përshkruhet se për këta artikuj kërkohet furnizim. Pasi që OE ankues nuk ka ofruar dëshmi për pozicionet e specifikuara me lartë, në bazë të shënimeve që mund të gjinden në internet si dhe kur krahasohen me objektin e kontratës çmimet e ofruara për këta artikuj nuk janë real me tregun për faktin se te këta artikuj të paramasës shumica e këtyre pozicioneve ngërthejnë në vete një mori elementesh përbërëse apo kërkesa që duhet të realizohen për tu kompletuar si pozicion e të cilët janë ofruar me 1.00, 5,00, 10.00 dhe 20.00 Euro, ndërsa nuk është ofruar ndonjë dëshmi se OE ankues mund të furnizohet me çmime të tilla. Nga përshkrimi si më lartë rezulton se çmimet e ofruara nga OE ankues janë jo normalisht të ulëta në krahasim me çmimet të cilat janë në treg. Në vijim po e paraqesim si shembull pozicionin 5.1 për të cilin është ofruar cmimi prej 20.00 euro, ndërsa është e pamundur që të gjendet në treg me këtë çmim. Në bazë të sqarimeve të specifikuara më lartë për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimore është i pa abazuar. Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike në e-prokurim, rrjedhjen dhe procedurën e prokurimit me këtë aktivitet të prokurimit është në përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues që vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave të bëhen në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP si dhe legjislacionit sekondar të prokurimit. Gjatë vlerësimit të gjithë OE pjesëmarrës të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes të cilat janë të vendosura nga ana e Autoriteti Kontraktues, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe të gjitha Anekset dhe kërkesat e specifikuara në dosjen e tenderit si dhe të respektohen në përpikëri kriteret e dhënies".

Sipas të thënave më sipër, raporti i ekspertit është hartuar në përputhje me autorizimin e Panelit Shqyrtues dhe ligjin në fuqi për prokurimin publik. Eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)".

OE ankues ka pohuar shkurtimisht se nuk pajtohemi me mendimin e expertit te lendes ngase sipas tij/saj experti ne fjale nuk i ka shqyrtuar te gjitha prendimet tona, nga 9 pretendimet tona I ka shqyrtuar vetem 2 prej tyre (te treten veten e ka permendur siparsisht). I njejti nuk ka dhene

asnje konstatim ku ne kemi sqaruar se komisioni i vleresimit nuk ka bere hulumtim te tregut ne asnjeren nga menyrat e hulumtimit te tregut,experti fare nuk ka dhene konstatim se a duhet komisioni te bente hulumtim por vetem nga bindja e tij personale ka dhene mendim se duhet te refuzohet oferta jone.Nuk qendron pretendimi i expertit lidhur me deklaraten e tije se ka pasur pretendime te cilat nuk kane qene te perfshira ne kerkesen per rishqyrtim,Ne si kompani e kemi pranuar expertizen me numer 0561/23 dhe nuk pajtohemi me mendimin e expertit te lendes.

Nga ana tjeter, AK ka deklaruar se pajtohet me vlerësimet dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues në ekspertizën nr. 2023/0561 me përjashtim cituar: s*a i përket çështjes lidhur me qasjen në dokumente zyrtare, e vëjmë në dijeni panelin se OE ankues iu është dhënë qasja zyrtare në dosjen e OE të rekomanduar me kontratë sipas kërkesës së tij dhe në pajtim me nenin 10 të LPP ashtu siç e vërteton procesverbali për qasjen zyrtare i cili është nënshkruar pa asnjë vërejtje nga përfaqësuesi i OE ankues. Andaj, duke qenë se vlerësimi i ofertave është bërë në përputhje me kriteret e parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit dhe është përzgjedhur tenderi i përgjegjshëm me ofertën që i përgjigjet më së miri planifikimit të prokurimit dhe përcaktimit të nevojave në kuptim të nenit 8 dhe 9 të LPP, kërkojmë nga paneli të marr vendim në atë mënyrë që e lë në fuqi vendimin e AK-ës të datës 21.07.2023.*

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP lidhur me nenin 40 të RRPP. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankues "RSM Company" Sh.P.K., fillimisht duhet sqaruar se me datë 13.12.2023 AK ka konfirmuar për OSHP se kontrata për të cilën po bëhet fjalë ka qenë kontratë publike kornizë për tri (3) vite me përgjigjet si në vijim: lidhur me kontratën "Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës për Lot V''e cila është lidhur datë 28.06.2018 me nr.44/2018 në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Operatorit Ekonomik „RSM Company'' SH.P.K. me seli në Prishtinë, ju infromojme se: ...Kontrata me nr.44/2018 ka qenë kontratë kornizë 3 vjeqare (36 muaj), ka përfuduar me datë 23.06.2021. Kontrata është lidhë me çmim njësi dhe është: 4.37 €, apo total për vit (209,865.01 euro) ± 30%, ndërsa vlera e punëve të realizuar për periudhën tre vite (36 muaj) është: 2018/2019 (208,838.17 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 18.06.2019 dhe dhe referencës me nr.5607 e datës 28.07.2020) 2019/2020 (205,950.59 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 05.05.2020 dhe dhe referencës me nr.5606 e datës

28.07.2020) 2020/2021 (250,964.53 € në bazë të raportit përfundimtar të punimeve të datës 23.06.2021 dhe referencës me nr.3621 e datës 12.04.2023). Raportet përfundimtare të punëve të kryera të cilët janë bërë në përfundim të secilit vit veç e veç të shoqëruara me referencat përkatëse...

Duke marrë parasysh këtë rrethanë, Paneli shqyrtues nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se nuk qëndron arsyetimi i AK se kjo kontratë nuk mund të pranohet me qëllim të përmbushjes së kërkesës përkatëse të dosjes së tenderit nga ana e operatorit ekonomik ankues. Paneli Shqyrtues parimisht konsideron se kontrata publike kornizë për të cilën bëhet fjalë në pretendimin ankimor është në përputhje me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Në këtë mënyrë nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues "RSM Company" Sh.P.K., dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të bazuara, megjithatë AK ka të drejtë që gjatë procedurës së rivlersimit ti verifikoj te gjitha këto raporte teknike dhe referenca te dorëzuara si dëshmi edhe nga AK Ministria e Infrastrukturës nëse eventualisht ka dilema për rregullsinë e tyre nga aspekti teknik/administrativ.

Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)", nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se janë plotësuar kushtet për cilësimin e ofertës jo normalisht të ulët sipas nenit 61 të LPP dhe nenit 4 të B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët. Prandaj Autoriteti Kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 4.2 të B57 Rregullat për Tenderët Jo Normalisht të Ulët kur me dt. 26.06.2023 ka kërkuar sqarime nga OE ankues për disa çmimet në pozicionet me nr. 1.6, 1.12, 1.13, 2.1, 2.2, 2.3, 3.2, pozicioni 3.2, 3.5, 3.7, 4.7, 4.9, 5.1, 5.3, 5.4 dhe 5.5. Me dt. 29.06.2023 OE ankues i përgjigjet AK duke ofruar çmime të furnizimit për disa pozicionet ndërsa nuk ka ofruar detaje tjera shtesë sikurse kërkohen në bazë të legjislacionit në fuqi. Në sqarimet e tij OE ka ofruar çmimet e furnizimit për pozicionin 1.6, 1.12 1.13, 2.1, 2.2, 2.3, 3.7 ndërsa për pozicionin 4.7 ka prezantuar dëshmi që çmimi i furnizimit të tyre është për disa herë me i lartë se sa çmimi me të cilin ka ofertuar. Ndërsa për pozicionet 3.2, pozicioni nen 3.2, 3.5, 4.9, 5.1, 5.3, 5.4 dhe 5.5 nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që të dëshmoj arsyeshmërinë e këtyre çmimeve. Pasi që OE ankues nuk ka ofruar dëshmi për pozicionet e specifikuara më lartë, si dhe nuk është ofruar ndonjë dëshmi se OE ankues mund të furnizohet me çmime të tilla, nga përshkrimi si më lartë rezulton se çmimet e ofruara nga OE ankues janë jo normalisht të ulëta në krahasim me çmimet të cilat janë në treg. Operatori ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)" nuk ka arritur ti dëshmoj me fakte dhe prova konkrete pretendimet e tija të paraqitura ankimore, andaj Paneli Shqyrtues i falë besimin e provës raportit të ekspertit si të mirëqene për refuzimin e ankesës se OE, ku thuhet se "nga përshkrimi si më lartë rezulton se çmimet e ofruara nga OE ankues janë jo normalisht të ulëta në krahasim me çmimet të cilat janë në treg". Në këtë mënyrë nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)", dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet kryesore ankimore janë të pabazuara. Rrjedhimisht pretendimet tjera edhe po të ishin të bazuara eventualisht, nuk do të mund të manifestonin efekt juridik në vendimin përfundimtar të Panelit Shqyrtues.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si me sipër, kurse AK obligohet të veproj në harmoni me këtë vendim dhe rekomandimin e ekjspertit shqyrtues në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-së. Pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e operatorit ekonomik "N.Sh. Liriu (Selman Kolgeci B.I.)" me nr. 2023/0561 e datës 10.08.2023 duhet të refuzohet si e pabazuar ndërsa ankesa e operatorit ekonomik "RSM Company" Sh.P.K. me nr. 2023/0549 e datës 07.08.2023 duhet të miratohet vetëm si e bazuar pjesërisht. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjilanit. të datës 21.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal, vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit" me nr. të prokurimit 651-22-10313-2-1-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 105 dhe 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 1,6 dhe pragrafi 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- OE - **N.SH. " Liriu "**
- Arkivës së OSHP-së: